

VENDIM
Nr.91, datë 6.8.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MUSO HEC QYTEZË” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Muso TEC Qytezë ” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Qytezë,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Muso HEC Qytezë” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.43 datë 11.4.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Shoqëria është mbajtëse e një kontrate koncesioni të formës BOT, me një afat 30-vjeçar për këtë hidrocentral.

4. Shoqëria ka paraqitur të plotë dokumentacionin e përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Licencimit.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Muso HEC Qytezë” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Qytezë për një kohëzgjatje prej 30 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta